

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-089/2015

Prishtinë, 2 gusht 2017

Në çështjen juridike të:

L. L. J.

Pala Ankuese

Kundër

Askush

Pala Përgjegjëse në Ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Erdogan Haxhibeqiri dhe Krassimir Mazgalov gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/R/255/2014 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave me numrin KPA33859) i datës 27 Gusht 2014, pas seancës gjyqësore kryesore, të mbajtur në 2 gusht 2017, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e L. L. J. e paraqitur kundër vendimit të KPCC/D/R/255/2014 sa i përket lëndës së regjistruara në AKP me numrin KPA33859 i datës 27 Gusht 2014, refuzohet si e pabazuar.
2. Konfirmohet vendimi i KPCC / D/R/255/2014 sa i përket lëndës së regjistruara në AKP me numrin KPA33859 i datës 27 Gusht 2014.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 28 Maj 2007 L. L. J. (në tekstin e mëtutjeshëm: Pala Ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës në emër të atit, S. L. tani i ndjerë, duke kërkuar ririposimin e banesës tredhomshe me sipërfaqe prej 90 m² e cila gjendet në Lagjen Farme, fshati Miradi e Epërme, Komuna e Fushë Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: prona e kërkuar). Ajo pretendon se babai i saj kishte të drejtën e shfrytëzimit në një banesë njëdhomshe por se me investimet vetanake e ka zgjeruar pronën në tre dhoma. Posedimin e kishte humbur në Qershor të vitit 1999.
2. Pala Ankuese bashkë me kërkesën ka paraqitur edhe këto dokumente:
 - Kontratën e shfrytëzimit Nr. 123 të datës 7 Shkurt 1988 e lidhur në mes KBI “KOSMET-EXPORT” dhe S. L,
 - Certifikatë e lindjes të datës 26 Gusht 1976 që dëshmon se S. L. është babai i L. L.J,
 - Certifikatë e vdekjes të datës 16 Tetor 2009 që dëshmon se S. L. ka vdekur me 11 Shtator 2001,
 - Vendime të ndryshme që dëshmojnë se pala ankuese është trashëgimtare e pasurisë së paluajtshme të S. L.
3. Identifikimi i kërkesës ishte bërë më 30 Janar 2008 duke e gjetur se pronën të shkatërruar kurse toka në të cilën ishte e vendosur prona nuk ishte e uzurpuar.
4. AKP-ja ka siguruar ex officio, të dhëna që dëshmojnë se prona e kërkuar është e regjistruar në emër të KBI “Kosova Export” ose “Kosmet Export” dhe se e njëjta i është nënshtruar privatizimit.
5. KKPK-ja e ka refuzuar kërkesën me vendimin KPCC/D/R/2255/2014 të datës 27 Gusht 2013. Në paragrafin 28 të vendimit grupor thuhet se kërkesa është jashtë juridiksionit të KKPK-së, sepse paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur të tregojë se ka pasur të drejtë pronësie mbi pronën e kërkuar sepse e njëjta është pronë shoqërore e dhënë në shfrytëzim.

6. Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 28 Tetor 2014. Ai ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme përmes aAKP-së më 25 Nëntor 2014.

Pretendimet e palës ankuese

7. Pala ankuese kërkon që Gjykata Supreme e Kosovës ta ndryshojë vendimin e KKPK-së, dhe t'ia njoh të drejtën në shfrytëzim të pronës banesore sepse ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme. Në atë truall ai pohon se babai i tij me mjetet e tija ka zgjeruar objektin banesor dhe pas vdekjes së tij ai ka jetuar i papenguar në pronë deri në Qershor të vitit 1999. Prandaj i kërkon Gjykatës Supreme që të marr vendim me të cilin i kthehet posedimi mbi pronën e kërkuar. Pala ankuese nuk e mohon dhe në kërkesë ka theksuar se i ati ka pas të drejtë shfrytëzimi në pronën e kërkuar.

Arsyetimi ligjor

8. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
9. Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se vendimi i ankimuar i KKPK-së ishte marrë me vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, dhe mbi atë bazë edhe e drejta materiale edhe e drejta procedurale janë zbatuar si duhet. Prandaj, ***ankesa refuzohet si e pabazuar.***
10. Për sa i takon Palës Ankuese, të cilit me vendimin për ndarjen e pronës i është ndarë trualli dhe banesa në shfrytëzim, Gjykata Supreme konstaton gjithashtu se kjo e drejtë e shfrytëzimit nuk është dhënë për pronën private. Nga dokumentet e prezantuar nga pala ankuese rezulton që ndërmarrja shoqërore ishte pronare e palujtshmerisë dhe se e njëjta është nënshtruar procesit të privatizimit. Prona banesore ishte shkatërruar në atë masë sa që nuk mund të përdorej për banim dhe nuk kishte aktivitet mbi tryuallin e kërkuar.
11. Në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, KKPK-ja ka kompetencë për t'i zgjidhur kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999: (a) kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e palujtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, dhe (b) kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së palujtshme private, ku paditësi për të dyja kategoritë nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat të tilla pronësor.
12. Për arsye se kërkesa nuk ka të bëjë me pronën e palujtshme private, KKPK-ja nuk ka pasur juridiksion të vendos lidhur me këtë kërkesë. Nga kjo dispozitë e aplikuar rrjedh se ankesa e Palës Ankuese është e pabazuar dhe kërkesa e tij duhet të refuzohet.

13. Lidhur me pronësinë e Palës Ankuese mbi objektin banesor të ndërtuar me mjetet e veta Gjykata Supreme thekson se çdo lloj kompensimi eventual i dëmit bie jashtë Juridiksionit të KKKP-së.
14. Rrjedhimisht, ankesa e Palës Ankuese refuzohet si e pabazuar dhe vendimi ankimor i KKKP-së vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
15. Ky aktgjykim nuk konfirmon asnjë të drejtë mbi pronën për shfrytëzuesit eventual e as që e paragjykon të drejtën e Palës Ankuese që ta referojë kërkesën në gjykatën kompetente jashtë juridiksionit të paraparë me dispozitat e nenit 3.1 të Ligjit nr 03/L-079.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Erdogan Haxhibeqiri, Gjyqtar

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte , Referent i EULEX-it